



VENDIM

Nr. 155, Datë 06.10.2016

**PËR
LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “XHENGO ENERGJI” SH.P.K, NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Ne mbeshetje te neneve 16; nenit 37, pika 2, gërma “d”; të Ligjit Nr. 43/2015 “Per Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 21 te “Rregullores per procedurat dhe afatet per dhenien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave ne sektorin e energjise elektrike” te miratuar me Vendimin e Bordit te ERE-s, Nr. 109, date 29.06.2016; gjithashtu dhe nenit 15 të “Rregullores per Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, date 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.10.2016, mbasi shqyrtoi relacionin per licensimin e shoqerise “XHENGO ENERGJI” sh.p.k, ne aktivitetin e Tregtimit te Energjise Elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut,

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “XHENGO ENERGJI” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike “si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Të dhënat specifike sipas tipit të licensës (neni 9, pika 4./10 gërmat “a”, “b” dhe “c”), janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Licensimin e shoqërisë “XHENGO ENERGJI” sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike për një afat 30 - vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të Njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI